

12.04.2021
Ora 17:50

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për një ndryshim në vendimin nr.11, të datës 25.03,2021 të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e ngritjes organizimit funksionimit të Komisionit të Qendrës së Votimit dhe zhvillimit të zgjedhjeve në qendrën e votimit”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

• **Komisioni Rregullator:**

1.Ilirjana	NANO	Kryetar
2.Arens	ÇELA	Anëtar
3.Dritan	ÇAKA	Anëtar
4.Helga	VUKAJ	Anëtar
5.Muharrem	ÇAKAJ	Anëtar

• **Stafi** **KQZ** **Y.Merkaj, N.Mezini, E.Meta**

Parti **Politike:** **PD, LSI, PDIU**

Znj. I. Nano: Mirëmbërëma, fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator të njoftuar për ditën e sotme. Në mbledhjen e Komisionit Rregullator marrin pjesë të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator. Merr pjesë Sekretari i Përgjithshëm i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe zyrtarë të tjerë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Marrin pjesë gjithashtu dhe përfaqësues të subjekteve zgjedhore të akredituara në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Në mbledhjen e sotme siç është njoftuar kemi në rendin e ditës dy projektakte për t’u shqyrtuar Projektvendimi “Për rregullat proceduriale për procesin e votimit dhe numërimit

Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.12.04.2021*

elektronik nëpërmjet pajisjes elektronike të votimit dhe numërimit (PEVN) në Qendrat e Votimit të Zonës Administrimit Zgjedhor nr.40 në Qarkun Tiranë, për zgjedhjet e Kuvendit, të datës 25 Prill 2021”. Projektakti i dytë në rendin e ditës është Projektvendim “Për miratimin e udhëzuesit të Komisionit të Qendrave të Votimit”. Së pari dëshiroj të pyes kolegët dhe përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore nëse kanë çështje jashtë rendit të ditës që dëshirojnë të diskutojnë? Nëse jo unë bazuar në nenin 24 të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit Rregullator”, me titull “Rradha e shqyrtimit të çështjeve në mbledhje”. Pika 3, me kërkesë të një anëtari Rregullatori me votim me shumicë të cilësuar, përfshin në rendin e ditës edhe akte të tjera që plotësojnë kushtet për t’u shqyrtuar në mbledhje të Rregullatorit ose shtyrjen e shqyrtimit të një akti në mbledhjen më të afërt. Personalisht bazuar në këtë nen të Rregullores dëshiroj t’i propozoj Rregullatorit që të përfshij në rendin e ditës një projektvendim që unë ua kam shpërndarë kolegëve, anëtarëve të Komisionit Rregullator për një ndryshim në vendimin e nr.11, datë 25.03.2021, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e ngritjes organizimit funksionimit të Komisionit të Qendrës së Votimit dhe zhvillimit të zgjedhjeve në qendrën e votimit”. E bëj këtë propozim sot paraprakisht, nëse do të votohet nga Rregullatori me shumicë të cilësuar, sepse e konsideroj të rëndësishëm për ta shqyrtuar së pari dhe më tej për ta miratuar para se të shqyrtojmë udhëzuesin e Komisionit në Qendrën e Votimit. Atëherë të nderuar kolegë hedhim në votim propozimin për një shtesë në rendin e ditës për projektvendimin e propozuar nga një anëtar i komisionit Rregullator.

Kush është dakord me këtë ndryshim në rendin e ditës?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S’ka

Me 5 vota pro miratohet një shtesë në rendin e ditës.

*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.12.04.2021*

Z. A. Çela: Faleminderit, unë propozoj për të hequr nga rendi i ditës projektaktin e parë për sa i përket në KZAZ-në 40 dhe për numrin elektronik pasi është një akt shumë i rëndësishëm dhe më nevojitet akoma dhe pak kohë për ta shqyrtuar.

Znj. I. Nano: Kolegë e hedhim në votim dhe propozimin e kolegut Çela për shtyrjen e shqyrtimit të këtij akti në mbledhjen më të afërt sipas Rregullatores për të mos e shqyrtuar sot?

Kush është dakord me këtë propozim?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet! Atëherë po bëjmë një rirenditje të akteve që do të shqyrtohen në mbledhjen e sotme. Kemi Projektvendimin për një ndryshim në vendimin nr.11, datë 25.03.2021 të Komisionit Rregullator "Për mënyrën e ngrijtes organizimit, funksionimit të Komisionit Qendrës së Votimit dhe zhvillimit të zgjedhjeve në qendrën e votimit". Pika e dytë e rendit të ditës Projektvendimin "Për miratimin e udhëzuesit të Komisionit të Qendrave të Votimit". E nisim me projektvendimin e parë si propozuese të këtij vendimi më lejoni të paraqes... Po zoti Kaziaj?

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Duke qenë se ka pasur një ndryshim të rendit të ditës dhe ne nuk jemi njohur me aktin. Të paktën të na vihet fizikisht në dispozicion nga ana e administratës.

Znj. I. Nano: Keni shumë të drejtë një kopje. Zoti sekretar i përgjithshëm nëse dikush nga administrata mund të shumëfishojë... Propozimi për ndryshim në vendimin nr.11, konsiston në një ndryshim. Unë po e sqaroj ndërkohë do të keni kopjen tuaj shumë shpejt. Nëse është e mundur një kopje mund t'ua kalojmë

*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.12.04.2021*

sepse është një kopje gati. Presim dy minuta sa të vijnë kopjet e projekvendimit. Atëherë ndryshimi i propozuar, konsiston në riformulimin e pikës 2 të nenit 32, të vendimit nr.11 sikundër e thamë “Për mënyrën e ngritjes organizimit, funksionimit të KQV-së dhe zhvillimit të zgjedhjeve në qendrën e votimit”. Në vendimin e datës 25.03.2021, pika 2 e nenit 32 është miratuar si më poshtë: “Sekretari i KQV-së regjistron të dhënat e zgjedhësit në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së dhe administron dokumentin e printuar nga PEI në zarfin ku shënohet “Vërtetime të Identifikimit Elektronik të Zgjedhësve”. Argumenti lidhur me ndryshimin e propozuar ka të bëjë me faktin që nuk është Sekretari i KQV-së ai që duhet të administrojë dokumentin e printuar nga PEI dhe këtë ka dashur propozimi të përcjellë. Atëherë në propozimin tim pika 1 e projektvendimit është në vendimin nr.11, datë 25.03.2021 të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e organizimit, funksionimit të Komisionit të Qendrës së Votimit dhe zhvillimit të zgjedhjeve në qendrën e votimit”, bëhen këto ndryshime:

- a) Pika 2 e nenit 32 ndryshohet si më poshtë vijon: Sekretari i KQV-së regjistron të dhënat e zgjedhësit në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së dhe pasi verifikon informacionin me dokumentin e printuar nga PEI dhënë nga operatori teknik, personi i autorizuar nga KQZ, e përcjell te Kryetari i KQV-së. Dokumenti fizik administrohet nga Kryetari i KQV-së në zarfin ku shënohet “Vërtetime të identifikimit elektronik të zgjedhësve”. Atëherë çelim diskutimin lidhur me këtë nen ju lutem kolegë? Po zoti Çakaj?

Z. M. Çakaj: Në fakt ky ndryshim i propozuar ka të bëjë me aktin e miratuar nga ky komision dhe konkretisht bëhet fjalë për nenin 32, zgjedhësi që tenton të votojë për herë të dytë. Sigurisht për procedurë duke qënë se roli dhe funksioni i Sekretarit të Komisionit të Qendrës së Votimit nuk është aktiv. Pra, nuk mund të marrë rolin e Kryetarit apo Nënkyetarit të Qendrës së Votimit. Sigurisht roli

*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.12.04.2021*

dhe detyrat e tij janë regjistrimi i të dhënave dhe ky ndryshim i propozuar nga Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, vjen në këtë frymë pra me rolin dhe funksionin e sekretarit. Kështu që për mendimin tim personal shkon në frymën e detyrave të përcaktuara për Sekretarin e Komisionit të Qendrës së Votimit në Kodin Zgjedhor dhe në aktet tona të miratuara. Kështu që besoj jemi dakord.

Znj. I. Nano: Keni ndonjë propozim, tashmë jemi të njëjtën situatë sikur ta ketë propozuar administrata këtë po e propozon një anëtar i Rregullatorit, projektaktin po e shqyrtojmë. Keni ndonjë propozim për ndryshim apo shtesë?

Z. M. Çakaj: Po një saktësim duke qenë se nuk e ka tagër Sekretari i Komisionit të Qendrës së Votimit të verifikojë informacionin, por e ka kryetari dhe sipas rastit nënkryetari. Do të doja që në pikën 2 pjesën e dytë të fjalisë është pika 1 e Projektvendimit, gërma “a”, të ndryshohet duke i dhënë atributin kryetarit apo nënkryetarit sipas rastit të Komisionit të Qendrës së Votimit, të verifikojë informacionin me dokumentacionin e printuar nga PEI. Më pas Sekretari i Komisionit të Qendrës së Votimit të regjistrojë të dhënat e zgjedhësit në librin e protokollit. Ndërsa fjalia e fundit është korrekte dokumenti fizik i printuar administrohet nga Kryetari i Komisionit të Qendrës së Votimit në zarfin ku shënohet “Vërtetimi të Identifikimit Elektronik të Zgjedhësve”. Pra konkretisht propozimi im është që të ndryshohet verifikimi informacionit duhet të kryhet nga Kryetari apo Nënkryetari i Komisionit të Qendrës së Votimit.

Znj. I. Nano: Kolegë ka ndonjë diskutim tjetër lidhur me këtë nen, nenin 1? Nëse jo votojmë nenin 1 me propozimin e zotit Çakaj dhe do të ftonim nëse do të miratohet, administratën për ta reflektuar në vendimin e zbardhur. Atëherë, Kush është dakord me propozimin e zotit Çakaj?

*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.12.04.2021*

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet! Pra, ndryshimi lidhet me atributet e sekretarit dhe kryetarit.

Pika 2: Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet!

Pika 3: Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Votojmë në tërësi projektvendimin për një ndryshim në vendimin nr.11 datë 25.03.2021 të Komisionit Rregullator "Për mënyrën e ngritjes, organizimit funksionimit të Komisionit Qendrës së Votimit dhe zhvillimit të zgjedhjeve në qendrën e votimit". Kolegë,

Kush është dakord me vendimin në tërësi?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet. Gjatë zbardhjes së këtij vendimi ju lutem të jetë parasysh propozimi i votuar dhe i miratuar i zotit Çakaj për ndryshime në germën "a".

Vendimi nr.15

*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*



12.04.2021
Ora 18:08

RENDI I DITËS

**Projektvendimi “Për miratimin e udhëzuesit të Komisionit të Qendrës së
Votimit”.**

PJESËMARRJA :

KQZ:

• **Komisioni Rregullator:**

- | | | |
|------------|-----------|-----------------------------------|
| • Ilirjana | NANO | Kryetar |
| • Arens | ÇELA | Anëtar |
| • Dritan | ÇAKA | Anëtar |
| • Helga | VUKAJ | Anëtar |
| • Muharrem | ÇAKAJ | Anëtar |
| • Stafi | KQZ | Y.Merkaj,E.Meta,N.Mezini,E.Numani |
| Parti | Politike: | PD, LSI, PDIU |

Znj. I. Nano: Pika e dytë e rendit të ditës është miratimi i udhëzuesit të KQV-ve. Është akt i përgatitur nga administrata e KQZ-së, vjen në mbledhje si propozim i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Ju lutem Sekretari Përgjithshëm zoti Merkaj një prezantim të aktit dhe relacionit përfshirë dhe ndryshimet më të fundit të udhëzuesit, faleminderit.

Z. Y. Merkaj: Referuar nenit 20, të Kodit Zgjedhor, Komisioni Rregullator shqyrton dhe miraton udhëzuesin dhe doracakët në shërbim të administratës zgjedhore, subjekteve zgjedhore dhe zgjedhësve. Udhëzuesi “Për organizimin dhe administrimin e procesit zgjedhor në KQV”, së bashku me Kodin Zgjedhor dhe aktet e tjera nënligjore, do të përdoren në kurset e trajnimit të trajnerëve të

Zbardhi materialin audio
Silvi SINO



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.12.04.2021*

KQV-së, dhe të anëtarëve të KQV-ve. Udhëzuesi “Për organizminin dhe administrimin e procesit zgjedhor në KQV” së bashku me fletoren e punës me modele të dokumentacionit të punës dhe shembuj praktikë, qartësojnë detyrat e KQV-së, nga momenti i ngritjes deri në dorëzimin e materialeve të votimit nga KQV-ja në KZAZ. Ai synon t’ju vijë në ndihmë anëtarëve të KQV-së për veprimtarinë e tyre në administrimin e procesit zgjedhor në KQV-së si dhe përvetësimi i procedurave të parashikuara në këtë udhëzues, do të ndikojë në:

- ngritjen e nivelit profesional e administrues të anëtarëve të KQV-së;

- zgjidhjen me profesionalizëm, paanshmëri, efektivitet nga ana e komisionerëve të KZAZ- ve të të gjitha problematikave të krijuara gjatë ushtrimit të detyrës;

- mirë administrimin e procesit zgjedhor dhe zbatimin ligjor të detyrave të tyre funksionale, në përputhje me parimet dhe rregullat e vendosura në Kodin Zgjedhor. Në kushtet e situatës së shkaktuar nga virusi Covid-19, është theksuar zbatimi në mënyrë rigorozë i masave dhe protokolleve të miratuara nga institucionet shtetërore. Udhëzuesi/manuali i KQV-së -së përbëhet nga 11 krerë, të strukturuar në ndarje si më poshtë:

Kreu I - Paraqet koncepte ligjore dhe parimet e përgjithshme që lidhen me sistemin e zgjedhjeve për Kuvendin, mënyrën e votimit nga zgjedhësit.

Kreu II - Paraqet në mënyrë të detajuar, rregullat për thirrjen, përgatitjen, zhvillimin e mbledhjeve të KQV-së, diskutimet, paraqitjen e propozimeve dhe votimin e tyre dhe marrjen e vendimeve.

Kreu III – Me 6 nën ndarje, qartëson mënyrën e marrjes në dorëzim të materialeve zgjedhore nga KQV-ja në KZAZ. Në çdo nën ndarje paraqitet marrja në dorëzim e materialeve zgjedhore, vulave metalik me kode sigurie, vulës së Kryetarit të KQV-së, lista e zgjedhësve.

Kreu IV – Me 5 nën ndarje, ku shpjegohet organizimi i qendres të votimit për ditën e zgjedhjeve. Gjithashtu pasqyrohen veprimet paraprake të KQV-së,

*Zbardhi materialin audio
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.12.04.2021*

kamera në KQV-së, procesi i regjistrimit të videos dhe skema orientuese e KQV-së.

Kreu V- Në dy nënndarje, jep informacion për të drejtat dhe detyrat e vëzhguesve.

Kreu VI- Jep informacion për procedurën e hapjes të votimit duke trajtuar në 4 nënndarje praninë e personave të autorizuar dhe anëtarëve në QV, mënyra e përdorimit të vulave dhe rastet e pajisjes së KQV-së me vulë rezervë.

Kreu VII – Trajton procedurat e detajuara gjatë votimit deri në përfundimin e tij.

Kreu VIII- Me 7 nendarje shpjegohen procedurat gjatë votimit ku trajtohet paraqitja e zgjedhësit në QV, votimi, raste të veçanta të identifikimit elektronik të zgjedhësit, veprimet që çënojnë procesin e votimit.

Kreu IX - Me 3 nënndarje shpjegohet mbyllja e votimit, trajtohet procedura për zgjedhësit që presin në radhë, raporti i mbylljes së identifikimit elektronik të zgjedhësve dhe veprimet pas mbylljes së identifikimit elektronik.

Kreu X- Funksionimi i PEI-it ku pasqyron veprimet e KQV-së kur PEI nuk funksionon.

Kreu XI- Me 3 nën ndarje shpjegohet procedurat për rastet e problematikave, dhe jepet informacioni për rastet e emergjencave, rasti i dëmtimit të pjesshëm të njësisë PEI dhe rasti i dëmtimit në USB-në kryesore të njësisë PEI.

Ky manual synon të ndikojë në rritjen e cilësisë së trajnimit dhe kryerjen e detyrave me standardet më të larta nga anëtarët e KQV-ve. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim. Dua të theksoj se teksti i udhëzuesit ka disa ndryshime nga projekti i dërguar para disa ditësh te Komisioni Rregullator, pasi janë bërë disa ndryshime të vogla në situatën dhe momentet e fundit, faleminderit.

*Zbardhi materialin audio
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.12.04.2021*

Znj. I. Nano: Zoti Merkaj, faleminderit. Para se të çelnim diskutimin për aktin edhe unë do të doja të falenderoja Administratën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe posaçërisht Drejtorinë e Komisioneve Zgjedhore dhe gjithë zyrtarët e tjerë të angazhuar në hartimin e këtij projektakti. Për këtë projektakt të detajuar në formën e udhëzuesit që do të shërbejë më së miri, qoftë për trajnimin qoftë dhe gjatë ditës së votimit për Komisionet e Qendrave të Votimit. Atëherë çelim diskutimin në parim për projektaktin. Në këtë fazë anëtarët e Komisionit Rregullator mundet së pari të flasin, më tej përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore, zoti Çaka?

Z. D. Çaka: Po, faleminderit. Akti i cili ne kemi sot në shqyrtim pavarësisht se në thelb është një udhëzues për Komisionin e Qendrës së Votimit, mendoj se është një nga aktet shumë të rëndësishme për t'i ardhur në ndihmë më shumë se rreth 35000 anëtarëve të qendrave të votimit, jo vetëm një ditë përpara por dhe gjatë ditës së zgjedhjeve në mënyrë që të zbatojnë me përpikmëri të gjithë dispozitat e Kodit Zgjedhor apo dhe akteve të tjera të Komisionit Rregullator apo dhe Komisionerit Shtetëror për Zgjedhjet. Dua të theksoj që në krahasim më zgjedhjet e tjera ky udhëzues ka disa risi që kanë të bëjnë kryesisht me teknologjinë e futur në këto zgjedhje në të gjitha qendrat e votimit dhe kanë të bëjnë me pajisjen në çdo qendra votimi me PEI që do të bëjë të mundur identifikimin e çdo zgjedhësi në çdo qendër votimi por njëkohësisht dhe kamerat që do të vendosen në çdo qendër votimi. Gjithashtu një risi është se në qendrën e votimit përveç anëtarëve të përcaktuar të Kodit Zgjedhor apo vëzhguesve të subjekteve politike është edhe një person tjetër që është operator, që do të bëjë të mundur nga fillimi deri në fund të gjithë këtë proces verifikimi. Dhe do jetë i vetmi person në qendrën e votimit që do këtë akses në këtë pajisjen, nëse anëtarët e qendrës së votimit nuk do ta kenë. Falenderoj edhe njëherë Administratën e Komisionit për sjelljen e këtij akti, i cili realisht është një punë voluminoze, sepse ka bërë përshtatjen dhe bashkimin e shumë akteve

Zbardhi materialin audio

Silvi SINO

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.12.04.2021*

ligjore dhe nënligjore për nxjerrjen e udhëzuesit për t'i ardhur në ndihmë anëtarëve të qendrave të votimit, faleminderit.

Znj. I. Nano: Faleminderit, po zonja Vukaj.

Znj. H. Vukaj: Padyshim që dhe ky akt merr rëndësinë e tij, është një nga aktet që mbush procesin por njëkohësisht garanton dhe për vijimin e rregullt të të gjithë procesit. Nga ana tjetër do të doja të nënvijëzoja atë që kolegu shprehu më parë, risitë dhe konkretisht prezencën e kamerave dhe teknologjisë së lartë të ofruar në këtë proces zgjedhor, siç janë tavolinat e numërimit që prezent do të kenë makineritë e skanimit të të gjithë fletëve të votimit gjatë procesit. Me këtë rast dua të theksoj kjo jo vetëm garanton procesin, rrit transparencën dhe nga ana tjetër jep besueshmëri publikut për votën e tyre, votën e numëruar dhe njëkohësisht pamundësinë ose minimizimin e çfarë do lloj taktike apo incentive për të manipuluar gjatë proceseve të ndërthurura me njëra tjetrën, faleminderit.

Znj. I. Nano: Faleminderit zonja Vukaj. Nëse nuk ka diskutime të tjera në parim ju ftojme të kalojmë në votim.

Kush është dakord në parim me projektvendimin?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet në parim projektvendimi!

Kalojmë nen për nen. Neni 1, Komisioni Rregullator vendosi :

Të miratoj udhëzuesin për KQV në ndihmë të anëtarëve të KQV për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021 sipas materialit bashkëlidhur.

Nëse nuk ka ndonjë koment të kalojmë në votim.

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

*Zbardhi materialin audio
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.12.04.2021*

Me 5 vota pro miratohet.

Neni 2, kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet.

Neni 3, ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ.

Votojmë dhe nenin e hyrjes në fuqi.

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet.

Momenti ta votojmë në tërësi projektvendimin, ndërkohë që nuk kemi pasur ndryshime gjatë shqyrtimit nen për nen.

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet.

Sapo kemi miratuar dhe projektvendimin për miratimin e udhëzuesit të KQV, atëherë sikundër diskutuam më herët projektvendimi për rregullat procedurale për procesin e votimit dhe numërimit elektronik nëpërmjet pajisjes elektronike të votimit dhe numërimit në qendrat e votimit të Zonës së Administrimit Zgjedhor nr.40 Qarku Tiranë për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë datë 25 Prill 2021 do të shqyrtohet në mbledhjen më të afërt të Komisionit Rregullator. Mbledhjen e deklaroj të mbyllur, faleminderit.

Vendimi nr.16

*Zbardhi materialin audio
Silvi SINO*

